

# 6

## Amnistitë ndaj AVL-ve dhe grumbullimi i armëve

### 6.1 Amnistia ndaj AVL-ve dhe legjislacioni e strukturat për grumbullimin

**KY PARAGRAF SYNON TË RISHQYRTOJË** dhe të nxjerrë mësim nga amnistia ndaj AVL-ve dhe proceseve të grumbullimit që janë ndërmarrë që nga 1997 si një kontribut për të zhvilluar programet për zhdukjen e armëve të paligjshme nga duart e civilëve në Shqipëri. Ai fillon me paraqitjen e bazës ligjore për periudhat e ndryshme të amnistisë dhe grumbullimit; prezanton metodologjitë vepruese që janë përdorur; rishikon kontributin e UNDP (si organizmi kryesor ndërkombëtar i përfshirë në grumbullimin e armëve); detajon rezultatet kyçe të programeve të mëdha të grumbullimit; dhe përfundon duke identifikuar mësimet për të ardhmen.

Për shkak të llojshmërisë dhe të rejave të qëndrimeve të përfutuara në Shqipëri vitet e fundit për të hequr armët e paligjshme nga duart e popullatës civile ka patur një sërë studimesh drejtuar mbi sukseset dhe dështimet përkatëse të tyre.<sup>562</sup> Ky Studim nuk ka qëllim të përsërisë gjetjet e këtyre studimeve por të tregojë në një farë mënyre nga perspektiva operacionale dhe e politikave elementët e ndryshëm që mund të jenë të dobishëm në çdo ndërhyrje të ardhshme.

### 6.2 Bazat ligjore për amnesti ndaj AVL-ve dhe grumbullimi i armëve

Në Gusht të vitit 1997, Qeveria Shqiptare vendosi amnesti për ata që i dorëzuan vullnetarisht armët e pajegjistruara tek autoritetet dhe kjo u përsërit vazhdimisht deri sa përfundoi në 4 Gusht 2002. Në 5 Gusht 1998, qeveria dekretoi Ligjin Nr. 8388 'Për Grumbullimin e AVL-ve'. Kjo vendosi parimet për dorëzim vullnetar të armëve që nuk ishin përdorur në krime, metodat që duheshin përdorur për grumbullimin dhe regjistrimin e armëve dhe municioneve ushtarake.<sup>563</sup> Sipas Nenit 21 të këtij ligji, sanksionet e vëna ndaj atyre që nuk pranorin të bashkëpunonin në këtë proces çarmatimi do të ishin me gjoba nga rreth 10,000 lekë në 100,000 lekë ose dënim prej

<sup>562</sup> Faltas S dhe Paes W-C, 'Ti zhduke djallin nga dera jonë': Një vlerësim i Projektit të Kontrollit të Armëve të Vogla dhe të Lehta në Shqipëri e UNDP (KAVL), (QSEJKAVL, 2003); Monitoruesit e AVL së Evropës Juglindore 2004 dhe 2005 (Saferworld dhe QSEJKAVL); Muggah R, *Të dëgjosh për ndryshim: Vlerësime pjesëmarrëse të DDR dhe Reduktimi i Armëve në Mali, Kamboxhia dhe Shqipëri*, (UNIDIR, 2005); Qendra për Studimet Rurale dhe Zhvillim të Vazhdueshëm, 'Projekti i UNDP në Shqipëri i KAVL për Analizat socio-ekonomike dhe Vlerësimi i Ndikimeve' (Shtator 2002).

<sup>563</sup> Këto parime vazhduan të aplikohen në legjislacionin pasardhës të grumbullimit të armëve. Proceset e magazinimit, dokumentimit dhe administrimit për armët e mbledhura theksohej gjithashtu në Marrëveshjen Gjyqësore Nr. 1214, 'Për grumbullimin, Magazinimin, Sigurimin, Administrimin e Armatim-Municionit dhe Materiale të tjera luftarake', 29 Mars 2000.

gjashtë muajsh sipas vendimit të gjykatës.

Ky ligj themeloi gjithashtu një sërë strukturash administrative dhe operacionale ndër-institucionale që duhet të ishin përgjegjëse për zbatimin e ligjit mbi grumbullimin e AVL në nivel kombëtar, prefekturë dhe lokal, përfshi këtu dhe një sektor të veçantë për grumbullimin e armëve, që deri në Maj 2000 kishte rekrutuar 250 nëpunës veçanërisht të ngarkuar me detyra dhe të trajnuar për grumbullimin e armëve. Ushtrisë iu dha përgjegjësia për magazinimin e armëve të grumbulluara në depot e saj.<sup>564</sup> Ky ligj deklaronte gjithashtu se komitetet në nivel prefekturë për grumbullimin e armëve do të ishin përgjegjëse për ndërgjegjësimin e publikut për këtë çështje dhe se duhet të hartonin plane për fushata ndërgjegjësimi.<sup>565</sup> Shqipëria është i vetmi vend në rajonin e Ballkanit që ka përfshirë në mënyrë eksplicite rritjen e ndërgjegjësimit mbi AVL-të në legjisllacionin kombëtar.<sup>566</sup>

Në mes të vitit 2002 u duk se amnestia për dorëzimin vullnetar të armëve nuk do të rinovohej dhe komisionet speciale dhe skuadrat e ngarkuara me grumbullimin e armëve do të pushonin së ekzistuari.<sup>567</sup> Kështu që pas 4 Gushtit 2002, amnestia e armëve pushoi dhe strukturat e grumbullimit të armëve u shpërndanë dhe anëtarët e grupeve të grumbullimit të armëve ose hoqën dorë dhe u angazhuan në detyra të tjera policore ose dolën pa punë.<sup>568</sup> Zyra e UNDP në Tiranë e kishte mbështetur fillimisht fundin e amnestisë, vetëm nëse ajo shoqërohej nga një përpjekje serioze për të arrestuar dhe përndjekur ata që u gjetën me armëmbajtje pa leje ose me pajisje ushtarake, dhe një ligj që mundësonte grumbullimin e armëve dhe nxirrte amnesti për periudha dhe zona të kufizuara.<sup>569</sup> Asnjë nga këto nuk ndodhi në vazhdim.

Me asistencën e UNDP u përgatit një projekt-ligj për amnestinë e kufizuar, po ai nuk u miratua nga Parlamenti. Në një shqyrtim të proceseve të grumbullimit të armëve mbështetur nga UNDP, Faltas dhe Paes u vu re se “nuk kishte një rritje të numrit të arrestimeve dhe të ndjekjeve penale për armëmbajtje pa leje” pas përfundimit të amnestisë pasi u duk se “Qeveria e kishte humbur interesin për mbledhjen ashtu dhe kontrollin e AVL-ve”.<sup>570</sup> UNDP dhe OJQ filluan të ndërhyjnë për një tjetër amnesti të përgjithshme,<sup>571</sup> dhe zyrtarët qeveritarë iu drejtuan UNDP për të hartuar një amnesti dhe ligj të ri për grumbullimin e armëve, që u miratua nga Këshilli i Ministrave në Dhjetor 2002.<sup>572</sup> Në 6 Mars 2003, Ligji Nr. 9018 “Për grumbullimin e armëve, municioneve dhe pajisjeve të tjera luftarake” hyri në librat e dekretive të Shqipërisë.<sup>573</sup>

Ligji i 2003 u krahasua me Ligjin e vitit 1998 mbi grumbullimin e AVL-ve për një sërë arsyesh. Ai kishte qëllime, parime, detyra të njëjta për policinë dhe ushtrinë, dhe të njëjtën strukturë piramidale të komisioneve të grumbullimit të armëve në Shqipëri (shiko figurën një më poshtë) – edhe pse komisioni qendror i grumbullimit të armëve u ishte gritur në një komision ndërministror për grumbullimin e armëve kryesuar nga Zv/Kyeministri.<sup>574</sup> I hartuar për të qëndruar në fuqi për dy vjet, ligji i vitit 2003 përfundoi në 31 Maj 2005 pa u zëvendësuar nga një ligj tjetër në fuqi. Zyrtarë të zyrës së UNDP MRSF në Tiranë, mesa duket kërkuan një shtyrje të ligjit edhe për një periudhë

<sup>564</sup> Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 12 Prill 2005.

<sup>565</sup> Neni 8, Ligji Nr. 8388 për ‘Grumbullimin e AVL’, 5 Gusht 1998.

<sup>566</sup> Monitorimi i AVL i Europës Juglindore 2005 (Saferworld dhe QSEJKAVL), f. 31.

<sup>567</sup> Ky pozicion u deklarua zyrtarisht nga kryetari i komisionit qendror të grumbullimit të armëve, Zv. Kryeministri Skënder Gjinushi, në një plan veprimi të hartuar në 14 Qershor 2002, dhe u përsërit në një mbledhje të veçantë të komisionit të grumbullimit të armëve në 24 Qershor 2002. I njëjti mendim u deklarua në një letër dërguar Gjinushit nga një grup pune i mbledhjes së armëve, që përbëhej nga zyrtarë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes, Pushtetit Vendor dhe Rendit Publik. Faltas S dhe Paes W-C, ‘Ti zhduke djallin nga dera jonë’: Një Projekt i UNDP në Shqipëri për Vlerësimin e Kontrollit të Armëve të Vogla dhe të Lehta (KAVL), (QSEJKAVL, 2003), f. 6.

<sup>568</sup> Intervistë, zyrtar i Ministrisë së Rendit Publik, 22 Prill 2005.

<sup>569</sup> Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 12 Prill 2005.

<sup>570</sup> Op cit Faltas dhe Paes, f. 5.

<sup>571</sup> Ndikimi i UNDP për një ligj të ri për amnestinë në 2002 u kritikua nga Faltas dhe Paes, edhe pse ata pranuan se kjo rrugë u mor për shkak të dështimit të qeverisë për të adresuar seriozisht çështjen e AVL të mbajtura në mënyrë të paligjshme. Ibid, f. 7.

<sup>572</sup> Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 12 Prill 2005.

<sup>573</sup> Sipas opinionit të një përfaqësuesi OJQ, që ishte përfshirë me hartimin e këtij ligji, këto vështirësi që e detyruan qeverinë të pranonte një amnesti dhe program tjetër të grumbullimit të armëve mund të kenë pasur lidhje me besimin e qeverisë shqiptare se kjo do të dëmtojte aspiratat e anëtarësimit të saj në BE. Intervistë, përfaqësues i OJQ, 30 Prill 2005.

<sup>574</sup> Ligji Nr. 9018, ‘Për Grumbullimin e Armëve, Municioneve dhe Materialeve të Tjera Ushtarake’, 6 Mars 2003.

2 vjeçare,<sup>575</sup> dhe kjo kishte të ngjarë pasi Zv/Kryeministri dhe kryetari i atëhershëm i komisionit ndërministror, Namik Dokle, informoi Saferworld se Qeveria planifikoi të linte në fuqi ligjin edhe për dy vjet të tjerë.<sup>576</sup> Gjithsesi, me ndryshimet në Qeveri dhe me Zgjedhjet e Përgjithshme të 2005, nuk ka aktualisht një bazë ligjore që të lejojë dorëzimin e armëve ose grumbullimin vullnetar apo qoftë dhe një angazhim të caktuar nga ana e Qeverisë për të zhvilluar plane të reja që t'i vërë këto çështje para Parlamentit.

## 6.3 Sipërmarrja për grumbullimin e armëve

### 6.3.1 Qëndrimi i Qeverisë

Me shkallë të ndryshueshme suksesi, programet në vazhdim të grumbullimit të armëve u ndërmorën në të gjithë Shqipërinë nga policia, e mbështetur nga strukturat qeverisëse lokale dhe shoqëria civile. Një aktor kryesor në procesin e grumbullimit gjatë pothuajse gjithë periudhës nën legjislacione të ndryshme të amnestisë ishte UNDP, që në kohë të ndryshme organizonte grumbullime me bazë stimuli në pjesë të veçanta të vendit (shiko paragrafin 6.3.2 më poshtë).

Në Maj 2000, skuadrat e veçanta të ngarkuara me detyrën për grumbullimin e armëve u bënë më në fund operuese. Detyrat e tyre përfshinë:

- Aktivitetet e rritjes së ndërgjegjësimit publik;
- Grumbullimin dhe regjistrimin e armëve të dorëzuara;
- Sigurimin e një magazinimi të sigurt të armeve të grumbulluara deri në transferimin e tyre në MM;
- Grumbullimin e deklaratave nga qytetarë shqiptarë, që citonin se familjarët e tyre nuk zotëronin armë të paregjisuara.

Të 250 anëtarët e skuadrave të grumbullimit të armëve ishin kryesisht oficerë policie dhe personel i mëparshëm ushtarak, të cilët u futën në radhët e skuadrave për aftësitë e tyre teknike dhe eksperiencën në menaxhimin e armëve dhe municioneve.<sup>577</sup> Trajnim shtesë u bë nga Sektori i atëhershëm i Grumbullimit të Armëve në Ministrinë e Rendit Publik (SGAMRP), dhe ky përfshiu kurse shtesë për skuadrat kryesore grumbulluese të Prefekturës dhe për menaxherin e magazinës.<sup>578</sup> Gjithsesi, metodat e praktikës më të mirë jo gjithmonë u ndoqën. Për shëmbull, kishte një numër rastesh kur karikatorët nuk ishin hequr nga armët e grumbulluara përpara se ato të çoheshin në depon e policisë.<sup>579</sup> Vlerësimi i përgjithshëm i ekspertëve teknikë të UNDP ishte se si policia ashtu dhe ushtria ishin të tërhequr në qëndrimin e tyre për sigurinë e armëve të mbledhura. Sidoqoftë, pati përmirësime të dukshme në komunikim në lidhje me sigurinë ndërkohë që programi i grumbullimit të armëve ecte përpara. Situata pa dyshim që ishte përmirësuar krahasuar me 1997, kur njerëzit “hidhnin kutitë e municioneve nga dritarja e katit të tretë në rrugët e Gramshit dhe dërgonin fëmijët me armë e artileri në vendet e grumbullimit”.<sup>580</sup>

Procesi i grumbullimit të armëve dhe trajtimi i mëpasshëm i armëve të grumbulluara tregohet në figurën 1.

<sup>575</sup> Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 12 Prill 2005.


<sup>576</sup> Intervistë, Zyra e Kryeministrit, 31 Mars 2005.

<sup>577</sup> Intervistë, ish zyrtar i MM, 18 Prill 2005.

<sup>578</sup> UNDP siguroi gjithashtu ekspertë teknikë, të cilët përgatitën dokumenta të sigurtë në gjuhën Shqipe.

<sup>579</sup> Një shëmbull i njohur i kësaj praktike të mirë u zbulua në Komisaratin e Policisë së Pukës sipas UNDP, Armët në Këmbim të Zhvillimit (Raporti final, Tiranë, Shqipëri, 1 Qershor 2002), pp. 35–7.

<sup>580</sup> Op cit Faltas dhe Paes, f. 6.

**Figura 1: Zinxhiri për armët e grumbulluara ose të dorëzuara vullnetarisht<sup>581</sup>**

Procesi i grumbullimit të armëve, sipas një të intervistuari, mund të bëhej në sheshin e një fshati, ose personi mund ta dorëzonte vullnetarisht armën(t) e tij në stacionin e policisë.<sup>582</sup> Në këto raste, kur arma u dorëzua, të paktën dy policë ishin prezent. Një mandat i lëshohej më pas personit që dorëzoi vullnetarisht armën dhe një kopje e mandatit dërgohej bashkë me armën në depot e policisë. Magazinieri lëshonte më pas një tjetër mandat, që tregonte se arma ishte marrë në dorëzim. Mandatet e lëshuara gjatë ditës grumbulloheshin për të dhënë një total ditor për të gjitha armët e marra dhe të magazinuara. Në fund të muajit, armët, municionet dhe eksplozivët që ishin grumbulluar numëroheshin dhe dërgoheshin në MM shoqëruar me dokumentet që jepnin detajet e dorëzimit. Armët e mbledhura transportoheshin më pas në bazën më të afërt ushtarake, ku menaxheri i magazinës ushtarake do të krahasonte mandatet për armët dhe municionin e marrë me anë të inventarit të tij fizik.<sup>583</sup>

Ndërsa ishte relativisht e lehtë të numërohej numri i AVL-ve të grumbulluara, shifrat e sakta të municionit, eksplozivëve dhe pajisjeve të tjera ushtarake duhen parë më skeptikisht. As polici që grumbulloi materialet luftarake, as menaxheri i magazinës nuk numëronin çdo copëz. Për më tepër, ata mund të mos kenë qenë në gjendje të identifikonin saktësisht llojet e ndryshme të copëve dhe eksplozivëve. Problemi u përkeqësua me faktin se armatimet dhe eksplozivët mund të jenë dorëzuar në shishe ose në enë primitive, të cilat policia nuk ishte e gatshme t'i hapte prej frikës se mos përmbajtja ishte e pasigurt. Prandaj, shifra zyrtare e regjistrimit të municioneve dhe eksplozivëve të mbledhur mund të ndyshojë nga përmbajtja aktuale e shishes së kokakolës dhe enëve plastike që njerëzit dorëzuan në polici. Gjithsesi, u deklarua gjithashtu se ata që ishin përgjegjës për të mbajtur shifrat e grumbullimit në polici dhe ushtri takoheshin çdo muaj për të diskutuar mbi parregullsitë në shifrat e tyre përkatëse të AVL, municioneve dhe eksplozivëve dërguar nga policia dhe marrë nga ushtria.<sup>584</sup>

Gjatë grumbullimeve të para të armëve dhe periudhës së amnestisë (1997–2002), është vlerësuar se oficerët Shqiptarë të policisë shkuan në më shumë se një milion shtëpi, duke u kërkuar njerëzve të dorëzonin vullnetarisht armët, ose të firmosnin një deklaratë që ata nuk zotëronin armë të paregjistruara.<sup>585</sup> Sipas specialistit të grumbullimit të armëve në Fier, kryetarët e komunave shoqëronin shpeshherë oficerët e policisë gjatë mbledhjes së armëve gjatë kësaj periudhe.<sup>586</sup> Përveç kësaj, njerëz të ndryshëm, mund t'i dorëzonin në teori armët e tyre të paregjistruara tek stacionet e

<sup>581</sup> Marrë nga: Program i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara, Armët në Këmbim të Zhvillimit, Raporti final, 1 Qershor 2002, Tiranë, Shqipëri, f. 31.

<sup>582</sup> Intervistë, ish zyrtar i MM, 18 Prill 2005.

<sup>583</sup> Bazat ushtarake shqiptare të përdorura për grumbullimin e armëve të mbledhura ndodhen në: Berat, Burrel, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Laç, Rrëshen, Shijak, Shkodër dhe Tiranë.

<sup>584</sup> Intervistë, ish zyrtar i MM, 18 Prill 2005.

<sup>585</sup> Quin D, et al 'Çarmatimi i civilëve në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni do të thotë t'i bëjmë ata t'i shohin armët si një kërcënim për sigurinë jo për garancinë', IRLPRKB 470, 27 Nëntor 2003, <<http://www.iwpr.net/>>, 07 Prill 2005.

<sup>586</sup> Intervistë, zyrtar i Ministrisë së Rendit Publik, 13 Maj 2005.

policisë lokale. Gjatë amnistisë së dytë dhe periudhës së grumbullimit të armëve (2003–5), u përdorën metoda të tjera. Një numër të intervistuarish përmendën nismat që mbanin parrullat ‘një armë më pak, një krim më pak’ ose ‘një polic, një armë’, që kishte të njëjtat metoda dhe qëllime – për secilin polic të mblidhej një AVL gjatë një periudhe fikse, p.sh një herë në muaj. Sipas Bajram Ibraj, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, u lëshua një urdhër që kërkonte që çdo polic të mblidhte 3 AVL, me gjoba për ata që nuk e zbatonin këtë detyrë dhe me shpërblime për ata që e kryenin atë.<sup>587</sup> Shpërblimi në të holla që u propozua së fundmi për policët që mblidhnin minimalisht 10 armë ishte një përpjekje për të kapërcyer letargjinë në emër të strukturave të Qeverisë, por sigurisht edhe të policisë.<sup>588</sup>

Fushata të tjera policore për grumbullim janë kryer në bashkëpunim me kompanitë e ruajtjes dhe sigurisë fizike, gjë që sipas një raporti çoi në grumbullimin e 200 armëve të zjarrit.<sup>589</sup> Në atë që duket të ketë qenë një episod i veçuar, ka patur raporte për një prift Katolik në Shkodër i cili shkonte derë më derë nën famullinë e tij për t’u kërkuar njerëzve t’ia dorëzonin armët e tyre ‘për Zotin’. Besohet që ai të ketë grumbulluar rreth 50 armë duke përdorur mënyrën e tij, megjithëse ne nuk mundëm të zbulonim periudhën kur kjo ka ndodhur.<sup>590</sup>

### 6.3.2 Kontributi i UNDP

Në Shkurt 1998 qeveria Shqiptare kërkoi asistencë nga Kombet e Bashkuara për çarmatimin e popullatës civile. Ata si fillim kërkuan krijimin e skemës ‘bli-mbrapsht’, sipas të cilës individët do të shpërbleheshin financiarisht për kthimin e AVL-ve, municioneve, eksplozivëve dhe pajisjeve të tjera ushtarake të grabitura. Muaj më vonë, Zv. Sekretarja e Përgjithshme për Çështjet e Çarmatimit pranë Kombeve të Bashkuara, Zj. Jayantha Dhanapala, bëri një mision në Shqipëri (11–14 Qershor 1998), e cila – pa habi – përjashtoi kërkesën për një skemë ‘bli mbrapsht’. Ata argumentuan se do të ishte tepër e kushtueshme, do të frynte çmimet e armëve dhe do të inkurajonte fuqimisht trafikimin në rajon.<sup>591</sup> Në vend të kësaj, misioni rekomandoi krijimin e një projekti pilot në Rrethin e Gramshit,<sup>592 593</sup> ku në këmbim të armëve të dorëzuara vullnetarisht komunitetet do të perfitonin projekte të vogla zhvillimi të financuara nga KB.

Projekti Pilot i Gramshit (PPG) zyrtarisht filloi në Dhjetor 1998, por u bë totalisht operativ në fund të Janarit 1999 kohë në të cilën aktivitetet u pezulluan për shkak të krizës në Kosovë. Projekti rifilloi aktivitetet e grumbullimit të armëve në Qershor 1999, duke vepruar deri në Gusht 1999. PPG nuk ishte vetëm një projekt pilot për grumbullimin e armëve në Shqipëri. Deri diku, ai pilotoi idenë e organizimit të një programi të grumbullimit të armëve që nuk shpërbleu individet për dorëzim vullnetar të armëve, por që siguroi *vetëm* një stimulim përmes financimit të vogël të projekteve të zhvillimit për komunitetin.<sup>594</sup> Ideja e shpërblimeve stimuluese kolektive u hodh si një faktor i ri dhe pozitiv, por u argumentua se ideja e përfshirjes së ‘komuniteteve’ është një faktor problematik në Shqipëri për shkak të ndarjes së shoqërisë pas periudhën post-komuniste.<sup>595</sup> Këto pikëpamje mund të mbështeteshin me argumenta nga rezultatet e një sondazhi të kryer në pranverën e 2005, sipas të cilit 34 për qind e të pyeturve besonin se llotaritë që ofronin shpërblime për individët do të vepronin si një stimul për njerëzit për të dorëzuar AVL në krahasim me vetëm 17.8 për qind e të pyeturve që deklaruan se shpërblimi komunitar do të vepronte si një stimul.

<sup>587</sup> Intervistë, zyrtar i MB, 25 Korrik 2005.

<sup>588</sup> Intervistë, zyrtar i MB, 26 Prill 2005.

<sup>589</sup> Intervistë, zyrtar i MRP, 23 Prill 2005; Quin, 2003.

<sup>590</sup> Intervistë, zyrtar i MRP, 15 Prill 2005.

<sup>591</sup> Op cit UNDP, f. 1.

<sup>592</sup> Gramshi është një rreth me afërsisht 100 fshatra, në Shqipërinë qendrore, me një popullsi prej 50,000 banorësh.

<sup>593</sup> Dy kandidatë të tjerë të mundshëm për projektin pilot – Vlora dhe Shkodra – dyshohej të kishin një numër të madh qytetarësh me armë të grabitura, por problemi ishte se Vlora ishte shumë e orientuar nga PS dhe Shkodra me PD. Të zgjidhje një nga këto rajone do të ofendonte partinë tjetër dhe do e ngatërronte detyrimisht UNDP-në në krizat politike. Intervistë, perfaqësues i OJQ, 30 Prill 2005.

<sup>594</sup> Op cit Faltas dhe Paes, f. 1.

<sup>595</sup> Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 29 Prill 2005.

Për shkak të një sërë faktorëve pozitivë, përfshi këtu edhe disa rezultate grumbullimi befasuese si dhe një perceptim se skema e shpërblimit po kuptohej më gjerësisht dhe po kërkohet nga një popullatë më e gjere, Qeveria Shqiptare reagoi ndaj eksperimentit në Gramsh duke kërkuar projekte bazuar në parime të ngjashme të aplikoheshin edhe në rrethet e Elbasanit dhe Dibrës.

Projekti 'Armët në Këmbim për Zhvillim (AKZH) veptoi nga 1 Qershor 2000 deri në Shkurt 2002 në rrethet e Dibrës dhe Elbasanit.<sup>596</sup> Kishte një buxhet më të madh se PPG,<sup>597</sup> por edhe AKZH mbajti të njëjtat qëndrime kryesore në përpjekje për të reduktuar numrin e armëve në komunitetet e përzgjedhura:

- Rritja e ndërgjegjësimit publik përmes medias së shkruar, TV, takime lokale nëpër qendrat e qyteteve, krijimi i një rrjeti OJQ dhe ngarje të tjera;
- Grumbullimi aktual i armëve, municioneve dhe materialeve eksplozive, dhe asgjësimi simbolik në publik i disa prej armëve të rikthyera;
- Zhvillimi në shkallë të vogël me bazë komunitetin në rajonet e Dibrës dhe Elbasanit.<sup>598</sup>

Sidoqoftë, rajonet e Dibrës dhe Elbasanit paraqitën probleme të ndryshme krahasuar me PPG. Për shëmbull, u argumentua se traditat e Dibrës, siç ishte dhe ligji i *Kanunit*, janë ruajtur në këtë zonë dhe janë ndjekur saktësisht, edhe gjatë kohës komuniste. Kështu për shëmbull, një nga sfidat kryesore ishte se zoterimi i armëve konsiderohej të ishte 'një e drejtë' e çdo burri mbi 18 vjeç. Për më tepër, nuk kishte përlllogaritje të dobishme mbi numrin e armëve në këtë rajon dhe kishte shërbyer si një rrugë trafikimi e armëve për në Kosovë dhe Maqedoni. Elbasani paraqiti një sërë problemesh të ndryshme, për faktin se u kishte siguruar strehim shumë refugjatëve që hynë në Shqipëri nga Kosova në krizën e 1999, duke e ngjeshur popullatën me 239,631 njerëz më shumë. Përveç kësaj, asgjësimi publik i armëve 'ishte konsideruar si aspekti më i ndjeshëm i dorëzimit dhe grumbullimit të armëve'.<sup>599</sup> Kjo sepse jo vetëm që kërkoi standarte publike të sigurta, por kërkoi lejen e qeverisë për të asgjësuar pasuritë e rekuperuara nga shteti – pasuri që qeveria mund t'i ketë konsideruar të vlefshme për ushtrinë ose për eksport.

Programi i tretë i grumbullimit të armëve e UNDP, i quajtur Projekti i Kontrollit të Armëve të Vogla dhe të Lehta (PKAVL), veptoi nga Prill 2002 deri në Dhjetor 2003. Ai u bazua në të njëjtat parime, dhe përdori të njëjtat metoda, si projektet e PPG dhe AKZH. Gjithsesi, Faltas dhe Paes argumentojnë se kishte ndryshim në eksperiencat e mëparshme me armët për projektet e zhvillimit në tre pika:

- Mbuloi më shumë territor se projektet e tjera: pesë prefekturat e Kukësit, Lezhës, Shkodrës, Tiranës, Vlorës dhe tre komunitetet në rrethin e Tepelenës;
- Gjithë procesi i grumbullimit dhe asgjësimit të armëve u krye nga autoritetet shqiptare;
- Jo të gjithë komunitetet që grumbulluan armë dhe morën pjesë në projekt morën projekte zhvillimi. Do të kishte një konkurrencë për sasinë e kufizuar të burimeve financiare të gatshme për projektet e zhvillimit.<sup>600</sup>

Është kjo pikë finale që është ndoshta pika më e ndryshme dhe ndoshta më e diskutueshme. Fakti që një komunitet që grumbulloi armë mund të mos merrte një projekt zhvillimi mund të kishte shfaqur probleme si për shëmbull interes të ulët sepse nuk do të kishte 'një shpërblim' të garantuar ose fyerje për 'fituesit' nga ata që ndien se nuk përfituan. Sipas Lawrence Doczy, drejtuesi i Programit Mbështetës i UNDP për Reformat në Fushën e Sigurisë, kjo nuk ishte kështu.<sup>601</sup> Sipas opinionit të tij,

<sup>596</sup> Faltas dhe Paes argumentojnë se emri i projektit ishte i papeështatshëm, pasi përmendte se armë u tregëuan për zhvillim. Ata preferuan emërtimin 'Çarmatim për Zhvillim'. Shiko: Op cit Faltas dhe Paes, f. 3.

<sup>597</sup> Projekti AKZH për Elbasanin dhe Dibrën patën një buxhet fillestar prej \$2,035,855, me donatorë përfshi Suedinë, Norvegjinë, USAID dhe Danimarkën. Departamenti Britanik për Zhvillim Ndërkombëtar u fut në listën e donatorëve të projekteve në një fazë të mëvonshme duke ndihmuar rritjen e buxhetit me \$1,000,000. Op cit PNUD, f. 17.

<sup>598</sup> Ibid, pp. 17–18.

<sup>599</sup> Ibid, pp. 21–22.

<sup>600</sup> Op cit Faltas dhe Paes, f. 3.

<sup>601</sup> Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 12 Prill 2005.

komunitetet që grumbulluan armët por që nuk përfituan projekte zhvillimi u dukën të ishin gati të pranonin rregullat e ‘konkurimit’.<sup>602</sup> Përsiatja e armëve në konkurrim për zhvillim erdhi si shkak i faktit se përmasat e territorit që duhej mbuluar ishin të mëdha krahasuar me buxhetin total të projektit. Kjo do të thoshte se nëse çdo komunitet që grumbulloi armë përfitoi nga projekte zhvillimi, atëherë do të kishte qenë aq i pallogaritshëm sa nuk do të kishte vlerë. Prandaj, projekte më të mëdha u vlerësuan të ishin një ndikim i madh me mundësinë konkurruese më të mirë për të inkurajuar pjesëmarrje më të madhe me një kosto të ulët.

Një sfidë tjetër për drejtuesit e projekteve ishte supozimi se amnistia e armëve do të mbaronte në 4 Gusht 2002. Prandaj, u prit që faza e grumbullimit të armëve do të zgjaste vetëm për katër muaj (Prill 2002–4 Gusht 2002). Sidoqoftë me prezantimin e ligjit të ri për amnisti në Mars 2003, një raund tjetër grumbullimesh u bë, si fillim ndërmjet Qershorit dhe Gushtit 2003 (të cilat u zbatuan nga autoritetet lokale dhe stafi i MRSF në mungesë të grupeve qeveritare për grumbullimin e armëve), dhe më pas përfundimisht ndërmjet 1 Shtator dhe 30 Nëntor 2003.

### 6.3.2.1 Kuptimi i kontributit të UNDP

Sic u tha dhe më parë, ekzistojnë tashmë studime që ekzaminojnë suksesin ose jo të kontributit të UNDP. Është e qartë se në kuptimin me bazë ishte një sukses për faktin se kishte më pak armë në duart e civilëve në fund të ndërhyrjes sesa në fillim. Është e qartë se UNDP dha më shumë vrull dhe angazhim për një çështje që në kohëra të tjera nuk ishte prioritet për Qeverinë Shqiptare ose komunitetin ndërkombëtar. Qëndrimet e zhvilluara dhe të testuara nga skuadra e UNDP kanë influencuar po ashtu në hartimin dhe zbatimin e skemave të ngjashme në një numër vendesh në rajonet e Europës Juglindore dhe më larg dhe mbështetja e fituar përmes projekteve të zhvillimit ka qënë pa dyshim e rëndësishme për shumë njerëz në komunitetet përfituese.

Disa prej elementëve që kanë ngritur pyetje nga ata që bënë vlerësimet (por që nuk mbahen detyrimisht nga autoret e këtij Studimi) përfshijnë:

- Ekzistonte mendimi se kishte më shumë interes në sasinë sesa në cilësinë e Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL) të mbledhura. Për shembull, një zyrtar që punonte në Shkodër deklaroi se vetëm 10 për qind e armëve të grumbulluara ishin në gjendje pune.<sup>603</sup> Prandaj, edhe pse grumbullimi i tytave të armëve, pushkëve me shula të ndryshkura dhe AVL të tjera te grabitura gjatë 1997 është në nivel të dëshirueshëm, nga ana tjetër është e diskutueshme nëse ato duhej të konsideroheshin si armë që përbënin një kërcënim për sigurinë publike. Kuadri i gjerë i synimeve dhe objektivave të projekteve të UNDP-së sigurisht që linte përshtypjen që ata jo domosdoshmërisht ishin fokusuar mbi reduktimin në mënyrë të veçantë në tipet e armëve që përbënin shqetësim më të madh për sa i përket trafikimit, të atyre që përdoreshin në aksidente, në krime apo në tensione midis komuniteteve të ndryshme.
- Nëse ndërhyrjet dhe projektet e zhvillimit të ofruara nga UNDP në zonat e përcaktuara në fokus kishin një ndikim më domethënës sesa grumbullimi/ amnistia e përgjithshme në pjesën tjetër të vendit. Për shembull, a ishin shumë më të larta nivelet e grumbullimit në zonat e përcaktuara në fokus sesa në ato zona ku nuk pati ndërhyrje të tilla? A rezultuan ndërhyrjet për më shumë AVL të dorëzuara vullnetarisht sesa po të mos kishte ndërhyrje të tilla? A mund të ishin arritur nivele të ngjashme grumbullimi po të mos kishte stimuj me projekte zhvillimi? A kanë dhënë rezultat stimujt apo llotaritë? Nuk është plotësisht e mundur t’i përgjigjesh me siguri të plotë këtyre tre pyetjeve të fundit, por shifrat e grumbullimit tregojnë se tre nga rajonet më përqindje më të ulët në grumbullimin e armëve në krahasim me armët e grabitura ishin të gjitha në qendër të ndërhyrjes së UNDP-së. (Tirana, Kukësi dhe Lezha).

<sup>602</sup> Ibid; shiko gjithashtu: Op cit Faltas dhe Paes, f. 12.

<sup>603</sup> Interviste, zyrtar i organizates nderkombetare, 13 Qershor 2005.

- Siç shihet në tabelën me ‘Statistikat për armët e mbledhura nga 1997 – deri Qershor 2005’ (në seksionin 6.4 më poshtë), tre rajonet me përqindjen më të madhe për armët e grumbulluara në krahasim gjithmonë me armët e grabitura nuk u bënë objekt i ndërhyrjes së UNDP-së (Korça, Berati dhe Gjirokastra). Tre rajonet që rezultojnë me totalin më të ulët në grumbullimin e armëve ishin gjithashtu objekt i punës së UNDP-së (Kukësi, Dibra dhe Shkodra), ndërsa dy nga rajonet me numrin më të madh të armëve të grumbulluara u bënë pjesë e programeve të zhvillimit dhe të grumbullimit të armëve të sponsorizuar nga UNDP-ja (Elbasani dhe Tirana; ndërsa Korça jo). Sigurisht që këto të dhëna nuk mund të provojnë në mënyrë definitive që ndërhyrjet e UNDP-së nuk kishin një impakt pozitiv dhe të vlefshëm mbi grumbullimin e armëve. Megjithatë, nëse programet e UNDP-së synonin në më shumë se grumbullimin e armëve – ashtu siç shprehen edhe përkrahësit e saj – atëherë do të ishte me vend të bëheshin vëzhgime dhe anketime gjatë gjithë këtij procesi në rajonet e ndërhyrjes dhe në rajonet e tjera që nuk kishte ndërhyrjen e saj, në mënyrë që të vlerësohej dhe krahasohej realisht impakti i UNDP-së, si dhe pjesa e kontributit të saj në gjithë përpjekjet për grumbullimin e armëve në shtetin Shqiptar.

Megjithatë, shumë studime të tjera kanë identifikuar qartë perceptimin pozitiv mbi ndërhyrjet e UNDP-së. Për shembull, vëzhgimi i vetëm i vlerësimit të opinionit publik për impaktin e ndërhyrjeve të UNDP-së u krye nga ana e Qendrës për Studime Rurale dhe Zhvillim të Qëndrueshëm në interes të AVL CP-së, dhe vetëm në rajonet e ndërhyrjes së UNDP-së. Vëzhgimi i tyre i vitit 2004 tregon se në masën mesatare prej 90 përqind të pjesëmarrësve në këtë vëzhgim nga komunat që kishin pasur projekte të zhvillimit të komunitetit kishin ngelur të kënaqur nga këto projekte.<sup>604</sup> Megjithatë, suksesi aktual i këtyre programeve në largimin e AVL-ve nga duart e popullsisë shqiptare u pyet gjithashtu në grupet e fokusit, kur në një numër rastesh të veçuara pjesëmarrësit ndjeheshin se edhe sikur dikush të kishte dorëzuar vullnetarisht një armë zjarri, ata kishte mundësi të kishin “nja dhjetë të tjera në shtëpi”. Kështu që, kur u pyet për të vlerësuar suksesin e projektit AKZH të UNDP-së, një nga pjesëmarrësit u shpreh:

*Të mendosh për sa i përket UNDP, ajo ka bërë shumë gjëra në shumë fshatra te prapambetura, por njerëzit në këto rajone kanë më shumë se një armë, pra ata kanë dorëzuar vetëm një prej tyre, dhe kanë mbajtur, le të themi dy të tjera. Pra, nuk mund të them se mund ta quajmë sukses këtë. Sepse fshatari i varfër nuk ndjehet i sigurtë, por ai ka nevojë për zhvillim, ai ka nevojë për rrugën, por atij i duhet edhe arma. Ç’të bëjë?*

**Fokus Grupi, Shkodër, Mashkull, Gusht 2005.**

Megjithatë, sipas një të intervistuarit nga rajoni i Shkodrës, gjithmonë e më shumë komunitete po bëheshin të interesuar lidhur me idenë e pjesëmarrjes në projektin e UNDP-së, për shkak se interesi i donatorëve ndërkombëtarë ishte duke u zbehur.<sup>605</sup> Sipas mendimit të tij, projekti transmetoi një mesazh pozitiv, tërhoqi më shumë vëmendjen dhe interesin në rajon që njerëzit e tij mund të përballen me problemet e tyre, dhe si e tillë ai duhet konsideruar si një sukses. Ai raportoi gjithashtu që në disa komunitete i kishin thënë se njerëzit ishin gati dhe kishin dëshirë të blinin armë me qëllim që të fitonin një projekt zhvillimi, duke demonstruar në këtë mënyrë se edhe metoda e zhvillimit të komunitetit mund të nxiste trafikimin e armëve.

Megjithatë, dikush mund të argumentojë që rezultatet e këtyre projekteve mund të krahasohen në mënyrë të favorshme në lidhje me grumbullimin e armëve në shtetet fqinjë dhe vendet e rajonit. Për shembull, projektet e UNDP-së në Shqipëri mund të konsiderohen më të suksesshme se projekti pilot AKZH i kryer në Kosovë në shtator 2003.<sup>606</sup> Po ashtu një program tre mujor i grumbullimit të armëve i kryer në Mal të Zi

<sup>604</sup> Parashikimet kryesore për këtë vlerësim të kënaqshëm duhet të gjëndeshin në Kukes dhe Tirana. Shih: citim i Qendrës për Studime Rurale dhe Zhvillim të Qëndrueshëm, faqe 36–7.

<sup>605</sup> Intervistë, zyrtar i spitalit, 14 Qershor 2005.

<sup>606</sup> Mustafa A dhe Jeta X, ‘Armësi armësh në Kosovë: Fushata shumë sensibilizuese dështon në bindjen e Shqiptarëve dhe të Serbëve të dorëzojnë armët e tyre’, IWPRBCR 464, 16 Tetor 2003, <<http://www.iwpr.net/>>, 18 Maj 2005. Pas tre muajsh fushatë të sensibilizimit publik, ky projekt grumbulloi vetëm 155 armë në një rajon që gjykohej se ka në vetvete rreth 330,000 deri 460,000 armë në duart e civilëve. Citohet Khakee dhe Florquin, Faqe 17

nga muaji Mars në Maj të të njëjtit viti, me asistencë nga USAID/ORT, grumbulloi 1,770 armë, 48,200 fishekë dhe 145 kg eksplozivë.<sup>607</sup> Numri i përgjithshëm i armëve AVL në duart e civilëve në Mal të Zi është vlerësuar në midis 126,000 deri 175,000 copë.<sup>608</sup> Prandaj, çdokush mund të vlerësojë se ndërhyrja e UNDP-së në Shqipëri duket se është e suksesshme në krahasim me sa më sipër.

## 6.4 Rezultatet e amnistisë/ proceset e grumbullimit të armëve

Në përgjithësi, zyrtarët shtetërorë kanë qenë më pozitivë për sa i përket rezultateve të amnistisë dhe të programeve të grumbullimit të armëve, sesa përfaqësuesit e OJQ-ve dhe pjesëmarrësit në grupet e fokusit, të cilit ishin më skeptikë nga deklaratat zyrtare. Pjesëmarrësit në grupet e fokusit ndjejnë se megjithëse çështjet e AVL-ve mund të mos jenë shqetësimi më urgjent i tyre, ata kanë shqetësimin se akoma ka shumë armë të paregjistruara në Shqipëri. Statistikat zyrtare zakonisht mbështesin shqetësimin e tyre që një numër i madh i AVL-ve të grabitura gjenden akoma në gjithë Shqipërinë, por edhe jashtë kufijve të saj.

Midis Marsit 1997 dhe Majit 2005, nga grumbulluesit e armëve dhe policia janë mbledhur 201,365 armë dhe 13,383 të tjera janë grumbulluar nga Ministria e Mbrojtjes (Ministria e Mbrojtjes duket se ka mbajtur rreth 60,000 nga armët e grumbulluara për nevojat e saj.<sup>609</sup> Po ashtu, 8,178 armë të grumbulluara mbahen tani nga policia ose janë regjistruar për banorët e kufirit dhe biznesmenët midis viteve 1997 dhe 2002. Prandaj, zyrtarë të grumbullimit të armëve thonë se nga shuma prej 549,775 AVL të grabitura nga depot e reparteve të Ministrisë së Mbrojtjes, të ish Ministrisë së Rendit Publik, dhe të SHISH-it, ata kanë llogaritur të grumbulluara deri tani 222,918 AVL. Po ashtu, 118,134,222 copë municione të ndryshme dhe 1,539,828 copë të municioneve xhenerike.<sup>610</sup> Një problem me këto shifra është se, për qëllime të grumbullimit, pjesë përbërëse të armëve si grykat, ose armë që duket se kanë qenë jashtë funksionimit organik për një kohë të gjatë, janë numëruar si një armë e plotë AVL.

**Tabela 32: Armët dhe municionet e grumbulluara, Mars 1997–Qershor 2005**

Vitet	Municione	Eksplosivë	Armë	UNDP
1997	44,273,651	187,618	72,548	
1998	13,481,537	19,660	10,547	
1999	11,740,789	5,490	6,909	<b>PPG 5,981</b>
2000	30,229,425	829,974	68,101	
2001	10,451,148	183,955	25,680	<b>AKZH 8,795</b>
Jan–07 Gusht 2002	4,956,793	146,426	17,078	
08 Gusht 2002–Tetor 2003	213,689	1,086	2,631	<b>AVLCP 9,718</b>
Nënt–Dhjet 2003	230,332	734	1,982	
<b>Totali 2000–2003</b>		<b>122,381</b>	<b>24,494</b>	
Jan–Dhjet 2004	1,941,493	157,096	13,306	
Jan–Mars 2005	315,394	2,490	2,658	
<b>Mars 1997–Qershor 2005</b>	<b>118,134,222</b>	<b>1,539,828</b>	<b>222,918</b>	
<b>Të Grabitura në 1997</b>	<b>839,310,038</b>	<b>16,000,000</b>	<b>549,775</b>	

Komisioni i Grumbullimit të armëve i llogarit të gjitha armët e grumbulluara në raport me numrin e armëve të grabitura me qëllim që të llogarisë përqindjen e armëve të kthyera. Kështu që, siç tregon tabela e mësipërme, statistikat e tyre shprehin se 201,365 nga shuma prej 524,226 e armëve të grabitura nga repartet ushtarake janë kthyer, e cila përbën një përqindje prej 40.5 të totalit.

<sup>607</sup> Citohet Florquin dhe O'Neill Stoneman, faqe 32–3.

<sup>608</sup> Po aty.

<sup>609</sup> Intervistë, zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes, 14 Prill 2005.

<sup>610</sup> Burimi: Njësia e grumbullimit të armëve në Ministrinë e Brendshme.

Tabela 33: Statistika mbi armët e grumbulluara nga 1997–deri Qershor 2005

Qarqet ose institucionet ku janë grabitur armët	Numri i armëve të grabitura	Numri i armëve të grumbulluara	Armët e grumbulluara në %
<b>Armë të grabitura në Ministrinë e Rendit Publik Shuma = 23,929</b>			
<b>Armë të grabitura në Shërbimin Informativ Kombëtar (SHISH) Shuma = 1,620</b>			
<b>Armë të grabitura në Ministrinë e Mbrojtjes</b>			
Drejt. Përgj. Qarkut në Berat	27,379	19,776	72
Drejt. Përgj. Qarkut në Diber	21,875	10,564	47.6
Drejt. Përgj. Qarkut në Durres	27,956	14,025	50
Drejt. Përgj. Qarkut në Elbasan	69,473	37,766	54.3
Drejt. Përgj. Qarkut në Fier	26,009	15,411	59.6
Drejt. Përgj. Qarkut në Gjirokastrë	22,855	15,643	68.1
Drejt. Përgj. Qarkut në Korçë	29,030	24,712	85
Drejt. Përgj. Qarkut në Kukës	26,930	4,730	17.6
Drejt. Përgj. Qarkut në Lezha	53,348	10,162	19
Drejt. Përgj. Qarkut në Shkoder	27,816	10,291	37
Drejt. Përgj. Qarkut në Vlore	24,733	15,028	60.6
Drejt. Përgj. Qarkut në Tirana	166,822	23,355	14
Shuma – Ministria e Mbrojtjes	524,226		
Shuma – Grumbullimi i armëve në Qarqe		201,463	
Armë të grumbulluara nga Ministria e Mbrojtjes		13,383	
Shpërndara për komisaritet e policisë, ose të regjistruara për banorët e kufirit dhe biznesmenët 1997–2002		8,176 <sup>611</sup>	
<b>Total</b>	<b>549,775</b>	<b>223,022<sup>612</sup></b>	<b>40.57%</b>

Gjithsesi, në rajone të veçanta ndarja e armëve që ngelen te pambledhura ishte e madhe. Për shembull, ndërsa disa nga armët e grumbulluara në Fier mund ta kenë origjinën nga depot ushtarake të Fierit, por ato mund të kenë ardhur në Fier nga rajone të tjera të vendit, për të mos përmendur gjithashtu edhe mundësinë që ato mund të kenë ardhur në Shqipëri nga vendet e tjera, ose mund të jenë mbajtur në mënyrë të paligjshme edhe para vitit 1997 (shih seksionin 3.4 dhe 3.5 më sipër, mbi trafikimin dhe armëmbajtjen pa leje).<sup>613</sup> Proporcioni i armëve të kthyer nga grabitjet e vitit 1997 mund të njihet më me saktësi nëse numrat serialë të armëve të mbledhura do të krahasoheshin me numrat e regjistruara të tyre në librat e armatim municionit të depove të vitit 1997. Kjo nuk ka ndodhur, dhe nuk ka pasur një dallim të qartë midis burimit të mundshëm të armëve të grumbulluara, tipit të tyre, ose nëse ato mund të funksionojnë akoma si armë.

Vlen të vërehet se shumatat totale të grumbullimit variojnë gjerësisht në të gjithë vendin. Berati, Korça dhe Elbasani ishin qarqet që u grumbulluan më shumë armë. Kukësi dhe Tirana ishin rajonet ku procesi i grumbullimit të armëve ka qenë më i vështirë.<sup>614</sup> Veriu i Shqipërisë paraqiti një sfidë duke mbajtur në konsideratë problemet e mëdha të pasigurisë, izolimit dhe konceptit kulturor të mbajtjes së armëve, duke shënuar kështu nivelet më të larta të mbajtjes së AVL-ve që trajtohen nga ky Studim.<sup>615</sup>

Megjithëse shifrat e grumbullimit të armëve, sipas raportimeve, ndahen në tipet e armëve të grumbulluara, autorët e tij nuk e morrën dot këtë ndarje. Prandaj, ne nuk jemi në gjendje të listojmë numrin e armëve të grumbulluara sipas tipit të tyre, ose të

<sup>611</sup> 8,178 sipas rregjistrimeve statistike të centralizuara.

<sup>612</sup> Mos përputhja e dukshme midis shumës e shifrave të grumbullimit dhe shumës e shifrave të grumbullimit në qarqe nuk i është shpjeguar plotësisht ekipit kërkimor, por kjo mund të jetë për shkak të problemit të shkëmbimit të informacionit midis ekipeve të grumbullimit të nivelit qëndror dhe atyre rajonal siç shpjegohet edhe diku në këtë raport. Shifrat e dhëna nga autoritetet shqiptare janë konsideruar si numri zyrtar i armëve të grumbulluara gjatë gjithë këtij raporti.

<sup>613</sup> Intervistë, zyrtar i qeverisjes vendore, 14 Maj 2005.

<sup>614</sup> Intervistë, zyrtar i MPR-së, 15 Prill 2005.

<sup>615</sup> Intervistë, zyrtar i MPR-së, 15 Prill 2005

llogarisim sasinë e secilit tip që mungon aktualisht. Ekspertë nga Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Brendshme e informuan ekipin kërkimor se, në përgjithësi, janë dorëzuar shumë pak pistoleta, e cila do të thotë që kërkesa për këto lloj armësh është akoma shumë e lartë, qoftë për mbrojtje personale qoftë për qëllime kriminale.<sup>616</sup> Pistoletat mund të mbahen të fshehura lehtësisht, dhe nuk ka pasur shumë mjete inkurajuese për civilët për ti bindur ata për ti dorëzuar këto lloj armësh.<sup>617</sup> Zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Ministrisë së Brendshme kanë deklaruar me një farë konfidencë se, shumica dërrmuese e armëve të grumbulluara janë pushkë, automatikë dhe pushkë automatike, të cilat kanë qenë prodhuar kryesisht në Shqipëri, në Kinë apo në Bashkimin Sovjetik.

## 6.5 Mësime nga përvoja shqiptare

Shqipëria ka qënë në shumë aspekte një terren prove shumë i rëndësishëm për të provuar e zhvilluar mënyra përfaqje ndaj problemeve të mbledhjes së armëve dhe mësimit që mund të merren nga përvoja shqiptare janë të dobishme përtej kufijve të saj. Ato janë gjithashtu me një rëndësi kritike për informacionin që japin për zhvillimin e politikave dhe për programimin e zgjidhjeve të problemeve që mbeten me mbajtjen e paligjshme të armëve nga civilët. Elementët e rekomanduar në vijim, pjesë e nj programi të suksesshëm për mbledhjen vullnetarisht të armëve, janë nxjerrë nga një analizë e projektit dhe nga vënia në jetë në Shqipëri në vitet e fundit.

### 6.5.1 Vendosja e një baze të rregullt, të qarte e të mirëbashkënduar për mbledhjen e armëve

Sipas mendimit të një zyrtari për sigurinë kombëtare pranë OSBE në Shqipëri, fakti që Qeveria shqiptare kishte nxjerrë një ligj për mbledhjen e armëve dhe amnistinë për ata që dorëzonin ato vullnetarisht ndërsa njëkohësisht mbajtja e armëve shihej edhe si një vepër penale krijoi probleme për vënien në jetë të vetë këtij ligji.<sup>618</sup> Megjithëse teorikisht një program për mbledhjen e armëve, një amnisti dhe një konsiderim i mbajtjes së armëve në mënyrë të paligjshme si vepër penale mund të veprojnë bashkarisht në të njëjtën kohë, u tregua se kishte shumë pak mundësi që ata që kapeshin me armë zjarri të parregjistruar gjatë periudhës së amnistisë do të dënoheshin me dënime burgimi. Ky qe mendimi i shprehur gjithashtu në një numër intervistash me politikanë të nivelit të lartë, drejtues të policisë, gjyqtarë, prokurorë dhe përfaqësues të shoqërisë civile në rajone të ndryshme të Shqipërisë. Kjo çështje u ngrit edhe në një grup fokusi në Shkodër, në mënyrën në vijim:

*A mendoni se këto amnisti janë të frytshme?*

– Po.

– Çudi. Një person që nuk e ka dorëzuar armën e tij përpara, nuk ka për të hequr dorë nga ajo edhe nëse afati i amnistisë zgjatet më shumë.

...

– Nuk ka asnjë kuptim që shteti të thotë të dorëzosh armën tënde edhe nga ana tjetër ti të mos dënohesh – me fjalë të tjera shteti ligjeron që ti të bësh dicka të paligjshme dhe nëse ti nuk e dorëzon armën tënde atëherë je me vonesë – çfarë nënkupton në të vërtetë ky afat? Gjithashtu, nëse shtyhet vazhdimisht afati njerëzit nuk do t'i dorëzojnë asnjëherë armët e tyre. Unë nuk mendoj se është afati që i pengon njerëzit që të dorëzojnë armët e tyre.

Fokus Grupi, Tiranë, Femra, gusht 2005.

<sup>616</sup> Intervistë, zyrtar i MPR-së, 26 Prill 2005; zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes, 18 Korrik 2005.

<sup>617</sup> Për shëmbull, kur ekipi kërkimor mori pjesë në një ceremony të grumbullimit të armëve në Komisaratin Nr. 1 të Policisë në Tiranë në 26 Prill 2005, nuk kishte asnjë pistoletë midis shumë prej 80 AVAL të grumbulluara që iu dërguan Ministrisë së Mbrojtjes.

<sup>618</sup> Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 29 prill 2005.

### 6.5.2 Sigurimi i zbatimit të ashpër, të ndershëm dhe transparent të ligjit

Një nga të anketuarit deklaroi se kur njerëzit të cilët kishin nënshkruar deklarata ku thuhej se ata nuk mbanin armë të parregjistruara dhe më vonë u ishin gjetur armë të tilla AVL, ata nuk i ishin nënshtruar ndonjë dënimi të ashpër për këtë.<sup>619</sup> Një tjetër i intervistuar nga Shkodra tregoi se në shumë raste, kur një person kapej nga policia me armë, gjithmonë pretendohet se ai po shkonte për ti dorëzuar ato armë në polici, duke iu shmangur kështu arrestimit dhe sigurisht edhe dënimit të rëndë në rastin kur çështja përfundonte deri në gjyq.<sup>620</sup> Një tjetër i intervistuar shkoi edhe më larg duke thënë se nuk ekzistonte një dëshirë e vërtetë për të dënuar njerëzit që mbajnë armë në mënyrë të jashtëligjshme, duke argumentuar se kjo jep mundësi për njerëzit në forcat e zbatimit të ligjit që të marrin si shkëmbim shpërblime për të rregjistruar një armë ‘të kapur’ si ‘armë e dorëzuar vullnetarisht’<sup>621</sup> Edhe kur raste akuzash për mbajtje të paligjshme të armëve arrinin deri në fazën e gjykimit, gjyqtarët kishin shumë mundësi dënimi nga paralajmërim, gjobë simbolike apo pak ditë burgim deri në gjoba rreth njëqindmijë leke apo shtatë vjet burgim.<sup>622</sup> Për shembull, një zyrtar i lartë i policisë në Drejtorinë e Policisë në Gjirokastrë deklaroi se nga tridhjetë raste të ditura arrestimesh për mbajtje të paligjshme të AVL, gjykatat nuk kishin dënuar asnjë dhe i kishin lënë të lirë të gjithë të arrestuarit.<sup>623</sup>

Sidoqoftë, shumë të intervistuar në këto rajone deklaruan gjithashtu se kishin dijeni për disa raste në të cilat ishin mbajtur parasysh dënime për armëmbajtje të paligjshme kur dënoheshin persona të cilët ishin gjetur fajtorë edhe për krime të tjera – psh. dënimi për armëmbajtje pa leje i shtohet dënimeve për vepra të tjera penale. Në shumicën e rasteve që arrinin në gjyq, të akuzuarit dënoheshin thjesht me gjobë apo me burgim jo më shumë se tre muaj. Në Shkodër, një individ i cili u kap për armëmbajtje pa leje për të katërtën herë dhe ishte dënuar më parë për vrasje u dënuua vetëm me dy vjet e gjysëm burgim. Sipas një të intervistuarit, dënimi ndaj tij duhet të kishte qënë të paktën pese vjet burgim e deri në pesëmbëdhjetë.<sup>624</sup> Shumica e zyrtarëve të policisë të intervistuar iu referuan meshirës – apo korrupsionit – të gjykatave si një nga problemet kryesore në përpjekjen për t’i dhënë një përgjigje të fortë mbajtjes pa leje të AVL gjatë periudhave të amnistisë.

Megjithëse një pjesëtar i drejtorisë për mbledhjen e armëve dhe politikën në bashkësi deklaroi se nuk kishte asnjë problem gjatë vënies në jetë të mbledhjes së armëve, amnistisë dhe ruajtjes në fuqi të ligjit që dënonte armëmbajtjen pa leje, ai gjithashtu deklaroi se përparësi i jepej thjeshtë mbledhjes së armëve AVL dhe se ligji mund të zbatohet në mënyrë “fleksibel” kur ishte puna për të mbledhur armët e parregjistruara – psh. ishte më mirë që të mos dënohej dikush që mbante një armë zjarri të parregjistruar nëse ky person nuk kishte bërë ndonjë krim tjetër.<sup>625</sup> Shumë zyrtarë të tjerë të policisë deklaruan se Shqipëria nuk ka as kapacitet në burgjet e veta për të kërkuar një zbatim të ashpër të ligjit mbi armëmbajtjen pa leje, duke qënë se edhe kështu burgjet shqiptare ishin të tejmbushura.<sup>626</sup>

Sipas një zyrtari për mbledhjen e armëve, në veprim brenda një force policore, Ministria e Drejtësisë do të bëjë një rishikim të nenit 278 të Kodit Penal në të ardhmen e afërt.<sup>627</sup> Ai besonte se në lidhje me këtë krim do të futeshin në fuqi dënime nga tre deri në shtatë vjet burgim. Nëse kjo është rruga e drejtë për të dalë nga gjendja, kjo mbetet për tu parë. Një mundësi më e mirë mund të ishte gjetja dhe dhënia e dënimeve jo më burgim të tilla si shërbimet në bashkësi apo edhe ulja e dënimeve me burgim. Në të vërtetë, në vitet e fundit është krijuar përshtypja se është politikisht më e lehtë që të

619 Intervistë, zyrtar i spitalit, 14 qershor 2005.

620 Intervistë, zyrtar i Ministrisë së Rendit Publik, 15 qershor 2005.

621 Intervistë, zyrtar i një organizate ndërkombëtare, 13 qershor 2005.

622 Intervistë, zyrtar i MD, 16 Maj 2005.

623 zyrtar i MB, 6 Gusht 2005.

624 Intervistë, zyrtar i MRP, 16 Qershor 2005.

625 Intervistë, zyrtar i MRP, 15 Prill 2005.

626 Intervista, zyrtar i MRP, 22 Prill 2005; zyrtar i MRP, 25 Prill 2005; Lluca, 14 Qershor 2005; zyrtar i MRP, 14 Qershor 2005. Në një intervistë pasuese në 14 July 2005, një zyrtar i MRP deklaroi se do të ishte e pamundur që të arrestohej dhe dënohej çdokush që mban një armë pa leje në Shqipëri.

627 Intervistë, zyrtar i MRP, 18 Prill 2005.

jepet një amnisti se sa të bëhen përpjekje për të arrestuar, përndjekur dhe burgosur ata që dyshohet se mbajnë armë pa leje në Shqipëri. Si rrjedhim, vendimi për të rritur dënimin për armëmbajtje pa leje do ngjante më shumë me një simbolikë boshë e diskutuar gjatë përpjekjeve për t'i dhënë një përgjigje të fortë problemeve që lidhen me armëmbajtjen pa leje se sa një përpjekje për të gjetur përgjigjen e duhur ndaj kësaj çështje.

### 6.5.3 Ruajtja e aftësive dhe motivimit

Një nga sfidat më kyçe e përmendur nga të gjithë personeli që merret me mbledhjen e armëve në rajone të ndryshme të intervistuar gjatë këtij anketimi është fakti që qëkur u shpërndanë ekipet për mbledhjen e armëve dhe amnistinë në 2002, puna për mbledhjen e armëve u bë shumë më e vështirë. Që nga viti 2003, ka pasur vetëm një numer shumë të vogël njerëzish me detyrë të posacme mbledhjen e armëve. Mbledhja e armëve është futur tashmë si një pjesë e detyrave të përgjithshme të oficerëve të policisë.<sup>628</sup> Mendohet se kjo ka qënë një nga arsyt kryesore në rënien e numrit të armëve të mbledhura gjatë amnistisë së viteve 2003–2005 dhe gjatë periudhës së mbledhjes së armëve megjithëse kjo nuk është një pikëpamje domosdoshmërisht e të gjithëve.

Ende ka një numër problemesh dhe sfidash me të cilat përballen ata që janë të interesuar në mbledhjen e armëve – qofshin këta persona të ngarkuar në mënyrë të posacme qofshin forca të policisë. Këto përfshijnë:

- Sigurinë e atyre që mbledhin armët dhe të vetë policisë kur këta veprojnë të vetëm atje ku autoriteti i tyre nuk respektohet apo ku ata janë në shënjestrën e mundshme të sulmeve;
- Mungesën e armëve dhe pajisjeve të tjera për vetëmbrojtje, të tilla si automjete dhe gjurmues metalesh;<sup>629</sup>
- Rrezikun e municioneve dhe eksploziveve të paqëndrueshëm;
- Vështirësinë e gjetjes së armëve të fshehura përballe metodave gjithnjë e më të sofistikuara të fshehjes;<sup>630</sup>
- Apatinë dhe normalizimin e pronësisë së armëve.<sup>631</sup>

Ndërsa disa policë janë optimistë se nëse bëhet një amnisti tjetër, disa nga njerëzit që mbajnë armë të fshehura do t'i dorëzojnë ato vullnetarisht,<sup>632</sup> shumë nga ata që janë ngarkuar me detyrën e bashkërendimit të mbledhjes së armëve nga policia raportojnë se ka një dozë të madhe “lodhje të mbledhjes së armëve” nga “oficerët e policisë”.<sup>633</sup> Nëse amnistia do të vazhdonte, ka gjithashtu shumë që thonë se vetë shoqëria shqiptare është e lodhur nga mbledhja e armëve dhe është gjërësisht indiferente ndaj fushatave të ndërgjegjësimit dhe thirrjeve për dorëzimin vullnetar të armëve.<sup>634</sup> Sipas të intervistuarve në strukturat e policisë në Gjirokastrë, nuk ka pasur ndonjë rritje për t'u vënë re në numrin e AVL-ve të dorëzuara në kohën para datës 31 maj 2005 që ishte afati për dorëzimin vullnetar sipas amnistisë (sic kishte pasur me afatin e amnistisë së vitit 2002).<sup>635</sup> Kjo sepse publiku tashmë e dinte se mund t'i mbante armët pa hasur shumë probleme duke ditur se askush nuk do të dënohej seriozisht edhe nëse autoritetet do t'i kapnin për armëmbajtje pa leje.

<sup>628</sup> Intervistë, zyrtar i MRP, 15 Prill 2005. Per shembull, Shkodra kishte 10 kolektore armesh perpara 2002, dhe vetem nje gjate amnestise 2003–5 (Interviste, zyrtar i MRP, 14 Qershor 2005). Ne Fier, kishte 12 kolektore armesh ndare ne qytetet e Fierit, Lushnjes dhe Mallakastres, qe u reduktua ne nje te tere per te gjithë qarkun e Fierit (Interviste, zyrtar i MRP, 13 Maj 2005).

<sup>629</sup> Op cit PNUD, pp. 33–4.

<sup>630</sup> Interviste, zyrtar i MRP, 15 Prill 2005.

<sup>631</sup> Nje gjetje e studimit baze te PNUD mbi grumbullimin e AVL drejtuar ne Shkurt 2004: Interviste, zyrtar nderkombetar, 12 Prill 2005.

<sup>632</sup> Interviste, zyrtar i MRP, 25 Prill 2005.

<sup>633</sup> Op cit South Eastern Europe AVL Monitor 2005, p. 26.

<sup>634</sup> Intervistë, zyrtar i qeverisë lokale, 14 Maj 2005.

<sup>635</sup> Intervistë, Alimema, 6 August 2005; zyrtar i MRP, 6 Gusht 2005.

#### 6.5.4 Fitimi i besimit tek mbledhja dhe mbledhësit e armëve

Mbledhja e armëve ishte tradicionalisht e pasuksesshme në zonat urbane me përjashtim të pjesshëm për Shkodrën.<sup>636</sup> Në zonat ku siguria publike është e larte dhe niveli i mungesës së sigurisë fizike është i ulët, është argumentuar se nuk dorëzohen armët për shkak të 'mendësisë' së qytetarëve shqiptarë. Vecanërisht, u përmend në një numër rastesh se ndërsa vazhdon mungesa e besimit në autoritetet dhe zyrtarët e shtetit, armët nuk do të dorëzohen.<sup>637</sup> Niveli i ulët i besimit që gëzojnë organet shtetërore sipas anketimeve të opinionit, vecanërisht organet e zbatimit të ligjit dhe ato të drejtësisë, tregon se ka ende një rrugë të gjatë për të bërë.<sup>638</sup> Ndoshta është pra me vlerë të vihet në dyshim aftësia e oficerëve të mëparshëm ushtarake dhe atyre të policisë për të mbledhur armët nga publiku i gjërë në vijim të ngjarjeve të vitit 1997. Gjendja mund të jetë drejt përmirësimit, por të intervistuarit shprehin akoma skepticizëm në lidhje me efikasitetin e organeve shtetërore.

Pjesëtarët e fokus grupit u prirën të theksojnë se ndërsa ligji nuk duket se po zbatohet dhe as nuk po përdoren faktorë të tjerë ndihmës shteti do të shihet se nuk po funksionon dhe qytetarë të zakonshëm do ta kenë më të lehtë për "të dalë në rrugë me armë për të terrorizuar njerëzit, edhe pa ndonjë arsye të vecantë. Kjo është rrjedhojë e dobësisë së shtetit dhe e mungesës së ligjit dhe rregullit". Shkëmbimi i mendimeve vazhdoi me një të intervistuar tjetër që deklaroi se:

*Ju mund të thoni se njerëzit janë të armatosur edhe në SHBA, ata të gjithë kanë leje për të mbajtur armë, por ama autoritetet shtetërore janë të pushtetshme dhe ligji atje vihet në zbatim. Më këtë nënkuptoj se fakti që njerëzit ketu kanë armë nuk është i vetmi problem. Shteti është problemi. Kështu, mbajtja e një armë pa leje është rrjedhojë e një shteti që nuk funksionon sic duhet.*

Fokus Grupi, Shkodër, Femër, gusht 2005.

Akoma sipas komisionit të opinioneve mbi të dhënat e mbledhura për këtë raport, 67.9 përqind e të pyeturve deklaruan se ata besonin se agjensitë shtetërore ishin vendosur më së miri për të inkurajuar njerëzit të dorëzonin vullnetarisht armët e mbajtura pa leje. Vetëm 12.8 për qind e të pyeturve selektuan udhëheqësit komunitare dhe 9.1 përqind e dhanë votën për përzgjedhjen e seleksionimit e organizatave ndërkombëtare. Renditja e ulët për organizatat ndërkombëtare mund të shihet me çudi krahasuar me vlerësimin më të lartë dhënë organizatave ndërkombëtare në sondazhe opinionit dhe me ndërhyrjet e PNUD në çështjen e grumbullimit të AVL-ve.<sup>639</sup>

#### 6.5.5 Një përjasje ndryshe

Sigurisht që jo të gjitha pjesët e shoqërisë shqiptare, dhe as pjesët të veçanta të Shqipërisë nuk kanë nivele të njëjta social-ekonomike dhe nivele të njëjta të sigurisë publike. Në këtë mënyrë, të intervistuarit në Kukës dhe Shkodër thonë që pavarësisht nga fakti se numri i të shtënave dhe i vrasjeve si rezultat i hakmarrjeve dhe i konflikteve të dhunshme për çështje pronësie është ulur kohët e fundit, njerëzit në zonat rurale të këtyre rajoneve kanë frikë se numri i konflikteve mund të rritet prapë, dhe vazhdojnë të mbajnë një armë për të mbrojtur veten dhe familjet.<sup>640</sup> Si rezultat, kur bëhet fjalë për mbledhjen e armëve, qëndrimin ndaj shtetit dhe qëndrimin për zotërimin e armëve është gabim që të gjithë shqiptarët të trajtohen në mënyrë të njëjtë. Si rezultat, një tjetër sfidë për programet e mbledhjes së armëve në Shqipëri ka qenë kapërcimi i ndryshimeve rajonale.

<sup>636</sup> Intervistë, zyrtar ndërkombëtar, 12 Prill 2005.

<sup>637</sup> Intervistë, Domi, 28 Prill 2005; zyrtar i MRP, 14 Maj 2005.

<sup>638</sup> Per shembull, sipas një sondazhi opinionesh në Maj 2005, 43 për qind e të pyeturve shprehën besim tek policia, ndërsa institucionet shtetërore të rradhura me poshtë ishin prokurorria dhe gjykata me 29 për qind dhe 25.7 për qind e të pyeturve shprehën besim në këto institucione respektivisht. Burimi: op cit Zgjedhjet 2005 Opinione Publike, 1 Qershor 2005, p. 20. See also: Kenney D J, Public Perceptions of the Police in Albania: Nationwide Surveys of Residents and Police (City University of New York and PNUD SSSR, 2004).

<sup>639</sup> Organizatat ndërkombëtare shënuan shkallën e besimit më të lartë në Maj 2005 nga opinionet e marra nga Gallup International dhe Mjaft. BE u rendit si e besueshme me 65 përqind të të pyeturve, OTAV me 64.5 përqind dhe OSBE me 57.1 për qind. KB nuk ishin në listë. Burimi: op cit Elections 2005 Public Opinion Polls, 1 Qershor 2005, f. 20.

<sup>640</sup> Intervista, zyrtarë të pushtetit vendor, 28 prill 2005; përfqësues të OJF-ve, 27 prill 2005; zyrtarë ministrie, 27 prill 2005; zyrtarë të MOPO-së, 14 qershor 2005; zyrtarë të MoJ-së, 15 maj 2005.


### 6.5.6 Stimujt e bazuar ose përqasjet e detyruara

Pjesa më e madhe e të intervistuarve kanë theksuar se amnistia, dorëzimi vullnetar dhe mbledhja e armëve nuk janë të mjaftueshme për t'i bërë njerëzit që të dorëzojnë armët e paregjistruara në polici ose tek organet e pushtetit vendor. Marrja e masave, ose dhënia e stimujve, ose një kombinim i këtyre dy elementëve do të çojë në kthimin e pjesës më të madhe të armëve – thonë të intervistuarit. Kështu, disa zyrtarë policie deklaruan që duhet ushtruar presion mbi njerëzit në mënyrë që ata të kthejnë armët, dhe atyre duhet t'u bëhet e qartë se mbajtja e armëve të zjarrit pa leje do të çojë në dënime të rënda. Disa besojnë se arrestimet dhe burgosja e atyre të cilët nuk i kanë kthyer armët në mënyrë vullnetare duhet të ishte bërë gjatë periudhës së amnistisë.<sup>641</sup> Sigurisht, ashtu siç e kemi parë dhe më lart, për të realizuar këtë gjë nevojitet vullnet politik dhe një zbatim korrekt i përcaktimeve ligjore. Gjithsesi, zbatimi korrekt i ligjit është një ndër çështjet e ngritura nga shumë të intervistuar, ndërkohë që disa zyrtarë policie kanë ngritur shqetësime programatike të lidhura me këtë çështje.

Sigurisht që kërcënimimi me burgut ose venia e gjobave do të ishin masa të mjaftueshme për disa shqiptarë. Si rezultat, është diskutuar se normalisht armët do të dorëzoheshin vetëm në rast se për këtë akt do të përcaktoheshin shpërblime ose stimuj.<sup>642</sup> Armët e grabitura mund të mos u kenë kushtuar në kosto grabitësve, por ata e dinin se armët kanë një vlerë, dhe sigurisht nuk duket si i kanë konsideruar ato si “pronë shtetërore”. Ashtu siç do të diskutohet në më shumë detaje më poshtë, mungesa e stimujve individualë nuk i ka penguar mijëra shqiptarë nga dorëzimi vullnetar i armëve të parregjistruara. Përsëri, në mjaft raste këto armë u dorëzuan pasi do të merrej një shpërblim i përbashkët për të gjithë komunitetin, i financuar nga projektet e PNUD-it. Ashtu siç është deklaruar nga një i intervistuar, programi i amnistisë dhe i mbledhjes së armëve do të realizohen në të vërtetë nëse shqiptarëve u jepet diçka në shkëmbim të dorëzimit të armëve.<sup>643</sup>

Në sondazhin e bërë në pranverë të 2005-ës nga ISO për këtë raport, pjesëmarrësve iu kërkua që të përzgjidhnin tre faktorët kryesorë që ata besonin që do t'i bënin njerëzit në komunitetin e tyre më të gatshëm për të dorëzuar armët e mbajtur pa leje. Rezultatet mund t'i shikoni në tabelën e dhënë më poshtë:

#### Cilat janë tri gjërat që do t'i bënin njerëzit që të dorëzonin armët e tyre pa leje?



Fakti se jo më shumë se gjysma e të intervistuarve besojnë që nivelet e sigurisë dhe të stabilitetit duhet të rriten përpara se njerëzit të bëhen të ndërgjegjshëm për dorëzimin e armëve të paligjshme vullnetarisht e përforcon më shumë idenë e dhënë në sugjerimet se suksesi i përpjekjeve për grumbullimin e armëve varet në më shumë elementë, dhe jo vetëm në strukturën e përcaktuar dhe në stimujt ose gjobat për të

<sup>641</sup> Intervista, zyrtar i MRP-së, 14 maj 2005; zyrtarë të MOPO-së, 13 maj 2005; zyrtarë të MOPO-së, 6 gusht 2005.


<sup>642</sup> Intervista, zyrtarë të pushtetit vendor, 12 maj 2005; zyrtar i MRP-së, 27 prill 2005; zyrtar i MOD-së, 13 qershor 2005; zyrtar i qeverisë vendore, 13 maj 2005.

<sup>643</sup> Intervista, zyrtar i organizatës ndërkombëtare, 13 qershor 2005.

dorëzuar ose për të mbajtur armët e parregjistruara. Ia vlen gjithashtu që të theksohet se pavarësisht nga elementi i dytë më i rëndësishëm i dhënë në tabelën e mësipërme, niveli i mbështetjes për këtë opsion ndryshonte shumë ndërmjet grupeve të ndryshme në Shqipëri. Për shembull, ndërkohë që 79% e të intervistuarve në pjesën qendrore të Shqipërisë besonin që një amnisti e përgjithshme përbënte një faktor domethënës për inkurajimin e dorëzimit të vullnetshëm të armëve të paligjshme, vetëm 49% e të intervistuarve në jug, 22% në veri dhe 19% në qendër mendonin se ky opsion do të ketë ndikim të madh. Vetëm 29 përqind e të intervistuarve në moshën 18–30 vjeç e zgjodhën këtë pikë, ndërkohë që të intervistuarit që i përkasin moshës nga 31–40 vjeç që zgjodhën këtë opsion janë në masën prej 46%. Nuk vihen re ndryshime të mëdha rajonale ndërmjet atyre që mbështetën idenë që projektet e zhvillimit të komunitetit do të shërbejnë si stimuj për të dorëzuar armët.

Megjithëse opinionet e ekspertëve të dhëna më lart sugjerojnë se njerëzit do të jenë të gatshëm që të dorëzojnë në mënyrë vullnetare armët e mbajtura jo ligjërish pa marrë stimuj, 69.4% e të intervistuarve në sondazhin e ISO deklaruan se kjo është mënyra që u sugjerojnë shokëve të tyre që të ndjekin për armët pa leje. Përqindja e të intervistuarve që përzgjedhën këtë opsion ra nga 80.5% në Tiranë në 69% në jug. Gjithsesi, ashtu siç tregon dhe tabela, më tepër se 20% e të intervistuarve i thonë miqve të tyre që ta mbajnë armën ose ta shesin atë për përfitime personale, ndërkohë që 6% e të pyeturve në veri u thonë miqve të tyre që ta mbajnë armën pasi mund të ndodhë që ajo t'u nevojitet. Mund të mendohet se numri i personave që u thonë miqve/shokëve të tyre që t'i mbajnë ose t'i shesin armët pa leje mund të jetë dhe më i lartë nëse individët do të vendosen përpara një situatë të tillë reale, dhe jo të pyeten në mënyrë hipotetike.

#### Çfarë do t'i këshillonit një miku të bënte me një AVL pa leje?



Sigurisht që do të ketë dhe nga ata që nuk do të binden që të ndahen nga armët e paligjshme që mbajnë, edhe në rast se do të ofrohet më shumë stabilitet, llotari, programe për rritjen e ndërgjegjësimit, programe edukative, programe zhvillimi ose vizita të policëve. Ndërkohë që të intervistuarit në këtë grup fusin kriminelët, qytetarët e zakonshëm nuk mund të përjashtohet plotësisht prej tij. Për shembull, në këtë grup mund të futet dikush për të ciklin një armë konsiderohet si e nevojshme për të mbrojtur veten ose familjen, ose kur mbajtja e një arme është pjesë e zakonit të zonës ku jeton ky person. Këto persona do të bënin çmos për t'u siguruar se armët e tyre nuk do të zbulohen, ndërkohë që dhe mbledhësit e armëve e dinë që njerëzit nuk i fshehin më armët nën krevate, por gjejnë vende më të vështira për t'u zbuluar.<sup>644</sup>